

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 21 KORRIK 2022

Së pari, edhe një herë dua të theksoj se kur djemtë e Kosovës flijonin jetën dhe derdhnin gjakun, kur Adem Jashari shndërroi Prekazin në Krujë të vërtetë, parafolësi i dekonfiguruar dhe i shtruar si pacient i pamjekuar, shiste ikona të vjedhura dhe spiunonte emigrantët në Paris. Shiste ikona të vjedhura, edhe një herë, këtë e ka thënë Fatos Nano. Është deklaratë e Fatos Nanos. Për sa i përket arrestimit të Hashim Thaçit, dua t'ju them sot të vërtetën: në procesin e arrestimit të Hashim Thaçit qëndron një trinom Kremlin-Beograd-Tiranë. Ky e mori, e futi Hashim Thaçin në spiralet e ndryshimit të kufijve në Ballkan. Ky i sugjeroi Thaçit të shtrëngonte duart me Putinin. Ky, bashkë me Ymerët dhe Klosët e tij, janë burime shpifjesh të pafundme.

Edi Rama, pra, futi udhëheqjen politike të Kosovës në një spirale, e cila në mënyrë absolute ndikoi në procesin e arrestimit të saj. Unë do diskutoj më vonë për të gjitha të vërtetat e raportit të Dick Marty-t, për të gjithë të vërtetat e hetimeve. Faktikisht, çdo gjë është me dokumente, por ky, që do të bëhet tani patriot, bashkë me Baton Haxhiun, janë dy promotorët e arrestimit të udhëheqjes politike të Kosovës. Këta ndërморën fushatën për anulimin dhe asgjësimin e gjykatës ndërkombëtare, gjë që tregonte indirekt përpjekjet për të fshehur fajësitë që nuk ekzistonin. Prandaj hidhet dhe kërcen këtu, sepse e di që në çdo variant del thjesht një argat dhe një vasal i Aleksandër Vuçiçit, sepse e di që në çdo samit është i damkosur si argat i tij, jo për Kosovën, përkundrazi, por planeve të Vuçiçit përpiqet në çdo samit t'u bëjë retushim, por këto janë njëri aspekt.

Aspekti tjetër është 7 korriku. Kurrë s'e keni parë në këtë platformë, nuk dua të përdor terma, por po them, të shkonfiguruar, të shpërfytyruar siç doli kësaj here. Qëndrimi ynë është pa diskutim ai që ka qenë gjithmonë, dhe unë e kam shprehur dhe do ta shpreh, jo vetëm këtu, por në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në Parlamentin Europian, në Këshillin Europian.